



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:265071
Datë: 20.05.2025
Numri i dokumentit: 07275876

K.DH.SH.II.nr.1411/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.T.P. “Yespharma”, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Selim Nikqi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., me seli në rr. Hazir Shala, nr.4 në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Maka, me objekt kontesti, kompensim dëmi, vlera e kontestit 167,738.84 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.538/22 të datës 04.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar ankesa e të paditurës Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.538/22 të datës 04.04.2024 dhe çështja gjykohet si në vijim:

1. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P. “Yespharma” dhe DETYROHET i padituri Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., që në emër të kompensimit të dëmit, të shkaktuar me datën 14.08.2009, si pasojë e depërtimit të ujërave të zeza në depon e paditëses e cila gjendet në Rr. “Shefqet Shkupi”, në Lagjen Kalabria në Prishtinë, t’ia paguaj paditësit shumën prej 83,869.42 €, (tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e katërdhjetë e dy cent), me kamatë në lartësi si për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar që paguhet në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 16.09.2009, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

2. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë nga shuma e aprovuar prej 83,869.42 €, (tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e katërdhjetë e dy cent) deri në shumën e kërkuar prej 167,738.84 €, (një qind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë euro e tetëdhjetë e katër cent) REFUZOHET SI E PABAZUAR

II. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 4,250.00 €, (katër mijë e dyqind e pesëdhjetë euro), brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Gjykata Komeriale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së parë”), me Aktgjykimin KE.nr.538/22 të datës 04.04.2024, (tani e tutje: “aktgjykimi i ankimuar”) me pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.P. “Yespharma” dhe e ka detyruar të paditurën Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., që në emër të kompensimit të dëmit, të shkaktuar me datën 14.08.2009, si pasojë e depërtimit të ujërave të zeza në depon e cila gjendet në Rr. “Shefqet Shkupi”, në Lagjen Kalabria në Prishtinë, t'ia paguaj paditësit shumën prej 167,738.84 €, (një qind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë euro e tetëdhjetë e katër cent), me kamatë në lartësi si për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar që paguhet në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 16.09.2009, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Në pikën II të dispozitivit është detyruar i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 8,500.00 €, (tetë mijë e pesëqind euro), brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
2. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë e paditura për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Komeriale – Dhomat e Shkallës së Dytë, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së dytë”): ta aprovojë si të bazuar ankesën ashtu që ta ndryshojë aktgjykimin KE.nr.233/23 dt.17.05.2024 të Gjykatës Komeriale – Dhomat e Shkallës së Parë ndërsa padinë e paditësit Yess Pharma ta refuzojë si të pabazuar apo që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.
3. Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditëses me propozim që aktgjykimi i atakuar të vërtetohet, ndërsa të refuzohet ankesa e të paditurës.
4. Gjykata Komeriale – Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komeriale, dhe nenit 194, dhe 195 të LPK-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës vlerësoi se:
 - Ankesa e të paditurës është pjesërisht pabazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Paditësi N.T.P. “Yespharma”, me datë 16.09.2009, pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur padi për kompensim dëmi kundër të paditurit Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që të kompensoj paditësin në shumën prej 230.679.54 €, në emër të dëmit të shkaktuar

nga mos funksionimi adekuat i pusëtës së kanalizimit të qytetit, e cila nuk ka mundësuar përcjelljen adekuate të ujërave të zeza, me rastin e reshjeve atmosferike, që për pasojë ka rezultuar përmbytjen e depos dhe prishjen e mallit – barnave farmaceutike dhe inventarit të paditësit. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.05.2011 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar kompensimin në emër të dëmit të lartcekur, në shumën prej 167.738.84 €, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

6. Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, si gjykatë e shkallës së parë, pasi ka administruar provat e propozuara, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pasi ka vlerësuar çështjen juridike kontestimore, me Aktgjykimin e atakuar ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar duke e aprovuar kërkesëpadinë si në dispozitiv.
7. Gjykata e shkallës së parë, pasi ka bërë vlerësimin e provave të administruara, pretendimeve të palëve dhe shkresat e tjera të lëndës në këtë çështje juridike kontestimore, ndër të tjera, ka ardhur në konstatimet si në vijim: Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara, rezulton se për asnjërën palë nuk ishte kontestues fakti se me datën 14.08.2009, në depon e paditësit e cila gjendet në Rr. “Shefqet Shkupi”, në Lagjen Kalabria në Prishtinë, kanë deportuar ujërat e zeza duke i shkaktuar dëm material, mirëpo në rastin konkret kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse përgjegjësia për shkaktimin e dëmeve si pasojë e depërtimit të ujërave të zeza, bie në barrë të paditurit, respektivisht nëse ekziston baza ligjore e krijimit të detyrimit dhe kompensimit të paditurit ndaj paditësit. Duke u bazuar në të gjeturat e ekspertit Sami Isufi dhe grupit të ekspertëve Shpëtim Lajçi, Sylejman Daka dhe Zenel Sejfiqaj si dhe nga provat tjera të lëndës, gjykata ka ardhur në përfundimin se deri te shkaktimi i dëmit në depon e paditësit, ka ardhur si pasojë e lëshimeve të paditurit. Meqenëse pala e paditur është kompetente për furnizimin me ujë si dhe trajtimin dhe largimin e ujërave të zeza dhe e ushtron këtë veprimtari, rezulton se e njëjta ka për detyrim edhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ushtrimi i veprimtarisë. Duke marr për bazë që raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin 2009, për vendosje në këtë çështje juridike, Gjykata i është referuar Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të datës 30 mars 1978 (tutje LMD). Në rastin konkret, bazuar në dispozitat e Nenit 154 par.2 të LMD-së gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura mban përgjegjësi për faktin se dëmi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurës dhe se dëmi është shkaktuar si pasojë e mosmirëmbajtjes së rregullt të kolektorit të kanalizimit përkatësisht mos pastrimit të rrjetit të kanalizimit dhe riparimit të pusëtave, ku kolektori kryesor ka dështuar që ti kanalizoj ujërat që kanë ardhur si pasojë e reshjeve dhe nga ngritja e nivelit të ujit në rrjet, është mbyllur kolektori kryesor dhe si rrjedhojë edhe është përmbytur depoja e paditësit, me ç ‘rast rezulton se i padituri ka përgjegjësi objektive për shkaktimin e dëmit.
8. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë bazuar në dispozitat e Nenit 194 të LPK, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, dhe vështuar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe

aplikimin e drejtë të së drejtës materiale, nuk mund ta përkrahë qëndrimi dhe përfundimi juridik të Gjykatës së shkallës së parë,.

9. Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë, në seancën e kolegjit, kjo gjykatë me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë; e po ashtu ka vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht.
10. Duke trajtuar pretendimet ankimore Kolegji vlerëson qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se nuk ka qenë kontestues fakti se me datën 14.08.2009, në depon e paditësit e cila gjendet në Rr. “Shefqet Shkupi”, në Lagjen Kalabria në Prishtinë, kanë deportuar ujërat e zeza duke i shkaktuar dëm material paditësit.
11. Me rastin e vërtetimit të fakteve vendimtare, ndonëse gjykata e shkallës së parë iu referuar provave të administruara, përfshirë këtu: Aktgjykimin P.nr.56/11, të datës 13.12.2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.I.nr.333/2019, i datës 18.04.2019, e njëjta fare nuk ka marrë parasysh faktet vendimtare që rrjedhin nga këto prova. Po ashtu, gjykata duke u bazuar në përgjegjësinë objektive (kauzale), vie në përfundim se e paditura mban përgjegjësi për faktin se dëmi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurës. Për cilësimin e veprimtarisë së të paditurës KRU Prishtina si veprimtari e rrezikshme, gjykata e shkallës së parë është mjaftuar me këtë kualifikim si veprimtari me rrezik të shtuar, pa dhënë ndonjë arsye bindëse. Me këtë rast, nën vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga përgjegjësia objektive, gjykata e shkallës së parë fare nuk ka marrë parasysh provat e tjera me rëndësi vendimtare për çështjen, duke ia atribuuar kështu të paditurës tërë përgjegjësinë për dëmin për shkak të veprimtarisë së rrezikshme.
12. Kolegji i kësaj gjykate duke i vlerësuar ndryshe provat që gjenden në shkresat e lëndës vie tek një kualifikim ndryshe në raport me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë sa i përket fakteve të çështjes dhe të drejtës materiale.
13. Para se të trajtohet përgjegjësia objektive konform dispozitave të Nenit 154 par.2 dhe 3 të cilat gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar me rastin e zbatimit të përgjegjësisë, është me rëndësi vendimtare të përcaktohet veprimtaria e rrezikshme konform Nenit 173 të LMD-së.
14. Ndonëse Ligji nuk përcakton shprehimisht çka konsiderohet send, respektivisht veprimtari e rrezikshme, Kolegji pajtohet me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se mund të konsiderohet veprimtari e rrezikshme ajo, mbi të cilën nuk mund të ushtrohet kontroll i plotë dhe gjatë së cilës, në çdo moment dhe në çdo kohë, pa asnjë lëshim të asnjërës palë, mund të paraqitet rreziku dhe mund të shkaktohen aksidente me pasoja të rënda.
15. Në një konstatim të tillë, kolegji nuk mund të pajtohet se në rastin konkret dëmi është shkaktuar vetëm dhe ekskluzivisht si pasojë e mosmirëmbajtjes së rregullt të kolektorit të kanalizimit përkatësisht mos pastrimit të rrjetit të kanalizimit dhe riparimit të pusetave, siç konkludon gjykata e shkallës së parë.

16. Sipas vlerësimit të Kolegjit provat që gjenden në shkresat e lëndës japin konstatime të tjera nga ato të konkluduara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke bërë kështu që të vihet tek një gjendje tjetër faktike e cila e ndryshon edhe përcaktimin e të drejtës materiale, respektivisht bazën e përgjegjësisë.
17. Fillimisht, Kolegji vlerëson se në shkresat e lëndës gjenden një aktgjykim penal (Aktgjykimit P.nr.56/11, të datës 13.12.2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.I.nr.333/2019, i datës 18.04.2019), me të cilin pronari i shtëpisë ku ka ndodhur dëmi H.J, është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, për veprën penale të Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 292 par. 1 të KPK-së. Dënimi për këtë vepër të njëjtë iu kishte shqiptuar pikërisht se prej datës së pavërtetuar, gjer me datën 14.08.2009 në Prishtinë, në podrumin e shtëpisë së të pandehurit e cila gjendet në Prishtinë, lagja Emshir, Rr. “Marin Barleti”, i njëjti ka dëmtuar instalimet e kanalizimit qendror, në atë mënyrë që ilegalisht, pa leje nga organi kompetent e ka lidhur kanalizimin e objektit – podrumit në sistemin e kanalizimit të kompanisë së Ujësjellësit Rajonal “Prishtina”, me ç ’rast i ka dëmtuar gypat dhe ka penguar rrjetin e kanalizimit, duke u kthyer uji brenda në podrumin e lartcekur-depon për barna të firmës NTP ‘Yespharma’, duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.
18. Për Gjykatën e Shkallës së Dytë kjo provë paraqet provë vendimtare për përgjegjësinë e pronarit të lokalit në kontributin për shkaktimin e dëmit, Duhet rikujtuar se gjykata në kuptim të Nenit 14 të LPK-së, sa i takon përgjegjësisë penale, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë. Së këndejmi, është e qartë se gjykata e shkallës së parë është përcaktuar për përgjegjësinë objektive nga veprimtaria e rrezikshme me rastin e përcaktimit të dëmit, megjithatë në rrethanat e rastit konkret duhet potencuar se me këtë provë qartazi ekzistojnë dëshmi për përjashtimin e përgjegjësisë objektive.
19. Sic thirret edhe gjykata e shkallës së parë, Neni 173 përcakton se *“Dëmi i lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send respektivisht nga kjo veprimtari me përjashtim në qoftë se provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.*
20. Te përgjegjësia objektive, pronari i sendit të rrezikshëm, respektivisht personi që merret me veprimtarinë e rrezikshme përgjigjet sipas rregullave të përgjegjësisë objektive për dëmin e shkaktuar nga ajo veprimtari, përjashtimisht nëse dëshmon se dëmi është shkaktuar me ndikimin e fuqisë madhore, fajin e personit të tretë apo fajësinë e të dëmtuarit. Kur dëmi shkaktohet me sendin e rrezikshëm apo nga veprimtaria e rrezikshme, shkak – kauzaliteti supozohet, por ky supozim mund të rrëzohet me dëshmi se ai send, respektivisht ajo veprimtari nuk ka qenë shkaktar i dëmit.

21. Në rrethanat e rastit konkret, fakti se pronari i objektit ku ka ndodhur dëmi, ishte gjykuar penalisht pikërisht se kishte dëmtuar instalimet e kanalizimit qendror, në atë mënyrë që ilegalisht, pa leje nga organi kompetent e ka lidhur kanalizimin e objektit – podrumit në sistemin e kanalizimit të kompanisë së Ujësjetës Rajonal “Prishtina”, me ç’rast i ka dëmtuar gypat dhe ka penguar rrjetin e kanalizimit, duke u kthyer uji brenda në podrumin e lartcekur-depon për barna të firmës NTP ‘Yespharma’, duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm material, për Kolegjin paraqet provë që e përjashton përgjegjësinë objektive të paditurës.
22. Fakt tjetër mjaft i rëndësishëm për të përcaktuar se veprimtaria e të paditurës në rrethanat e rastit konkret nuk mund të përcaktohet si e rrezikshme janë konstatimet e grupit të ekspertëve në përbërje prej Shpëtim Lajçi, Sylejman Daka dhe Zenel Sejfiqaj, të cilët në mesin e shumë të gjeturave kanë ardhur tek konstatimi i bazuar mbi provat e siguruara nga Instituti Hidro Meteorologjik i Kosovës (IMHK) se “... reshjet e datës 14.08.2009 me vlerë prej 26.5 [mm] (1/m2) nuk ka mundur të paraqesin vërshime ekstreme” Shih ekspertizën e Grupit të Ekspertëve fq.70 par.7). Më tej ekspertët konstatojnë se “si rrjedhës e kësaj rritje e nivelit të ujit në rrjetin e kanalizimit – kolektorit fekal ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit normal të rrjetit ekzistues për largimin e ujërave atmosferike dhe fekale”.
23. Nisur nga konstatimet e ekspertëve se reshjet nuk kanë mundur të paraqesin vërshime ekstreme, dhe pa përjashtuar faktin se pronari i shtëpisë ishte gjykuar penalisht, ndër të tjera se në lokalin që ishte objekt kontesti ka dëmtuar instalimet e kanalizimit qendror, ashtu që ilegalisht, pa leje nga organi kompetent e ka lidhur kanalizimin e objektit – podrumit në sistemin e kanalizimit të kompanisë së Ujësjetës Rajonal “Prishtina”, me ç’rast i ka dëmtuar gypat dhe ka penguar rrjetin e kanalizimit, vihet në konkludim se depërtimit i ujërave të zeza në depon e e paditëses nuk mund të kualifikohet si dëm i shkaktuar nga veprimtaria e rrezikshme e të paditurës, përderisa me prova ishte mënjanuar përgjegjësia nga veprimtaria e rrezikshme.
24. Në rastin konkret fakti se ekziston fajësia sipas përgjegjësisë penale të pronarit të objektit pikërisht në kontributin e drejtpërdrejtë për shkaktimin e dëmit, Kolegji çmon se dëmi ka ardhur në masë të konsiderueshme edhe nga lëshimet, respektivisht ndikimi i personit të tretë dhe jo nga kauzaliteti i veprimtarisë së rrezikshme. Ndikimin dhe përgjegjësinë e pronarit të lokalit – qiradhënësit e kanë konstatuar edhe grupi i ekspertëve. Është indikative se të njëjtit në mendimin e tyre profesional lidhur me përgjegjësitë e pronarit H.J., theksojnë se “ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në pikën III (përfshirë këtu Neni 24 të Ligjit – kycjet e paligjshme). Po ashtu ekspertët kanë konstatuar këtu lidhjen e bodrumit me pusëtën e kolektorit të kanalizimit jo të mbyllur (neutralizuar) e cila ka mundur depërtimin e fekaleve në bodrumin e dhënë me qira me rastin e ngritjes së nivelit të ujit.
25. Të gjitha konstatimet e lartcekura të ekspertëve përputhen me pjesën e përgjegjësisë penale për të cilën ishte gjykuar pronari i lokalit, fakt ky i cili e mënjanon përgjegjësinë sipas kauzalitetit, respektivisht nga veprimtaria e rrezikshme. Kjo për faktin se depërtimi i ujërave të zeza në lokalin e paditësit nuk ka ndodhur vetëm me faktin e ndodhjes së rastit mbi të cilën nuk mund të ushtrohet kontroll i plotë, pa asnjë lëshim të asnjërës palë. Por është dëshmuar se deri te dëmi nuk do të ishte ardhur nëse “palët e përfshira në këtë raport kishin bërë një veprim nuk kishte

me ardhë deri te përmbytja” – siç konstatojnë ekspertët në seancën e dt.20.02.2022 (shih procesverbalin e dt.20.02.2022)

26. Kolegji konkludon se në rrethanat e rastit konkret plotësohen kushtet ligjore për lirimin e përgjegjësisë nga përgjegjësia objektive, sipas dispozitave të nenit 177 të LMD-së, respektivisht se përgjegjësia për dëmin duhet trajtuar sipas përgjegjësisë subjektive – sipas fajit.
27. Sipas Kolegjit e paditura me aktgjykimin penal me të cilin pronari H.J., ishte shpallur fajtor ndër të tjera për kyçje ilegale, pa leje nga organi kompetent në kanalizimin e objektit duke i dëmtuar gypat dhe ka penguar rrjetin e kanalizimit, ka arritur të dëshmojë mjaftueshëm se ekzistojnë rrethanat nga lirimi i përgjegjësisë objektive, pasi që personi i tretë – pronari i lokalit ka kontribuar në shkaktimin e dëmit – dëm ky i cili nuk mund t’i atribuohet në tërësi ta paditurës sipas përgjegjësisë objektive. Kjo për faktin se dëmi nuk ka ardhur nga veprimtaria e rrezikshme si e tillë, por përkundrazi me fajin e palëve të përfshira të cilët me veprimet e tyre kanë ndikuar dhe kanë kontribuar në veprimin dëmtues. Këtë konstatim më së miri e përcaktojnë grupi i ekspertëve të inxhinerisë (hidrologjisë) të cilët në seancën e dt. 20.01.2022 konstatojnë se “... nëse ujësjellësi e kishte mbajtur rrjetin si duhet nuk kishte ardhur deri te ngritja e nivelit të ujit që me u ba përmbytja, nëse pronari i shtëpisë e kishte bërë mbylljen si duhet teknikisht nuk kishte ardhur deri te përmbytja, nëse këtu paditësi të kishte pasur kujdes a ka leje ndërtimore, a ka pëlqim nuk ishte bërë përmbytja ...”
28. Përkitazi me konstatimet e lartcekura, Kolegji vie në përfundim se nga trajtimi ndryshe i provave ka ardhur deri tek një gjendje tjetër faktike, nga e cila vihet në përfundim se në rastin konkret palët e përfshira kanë kontribuar në shkaktimin e dëmit, duke vlerësuar se dëmi nuk mund të trajtohet si përgjegjësi kauzale e ta paditurës ekskluzivisht për shkak të veprimtarisë së saj, por si dëm i ardhur me fajin dhe kontributin e palëve të përfshira.
29. Nga kjo gjendje faktike, Kolegji çmon se edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht ashtu që gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka bazuar vendimin e saj në dispozitat e nenit 154 par.2 dhe 173 të LMD-së. Por, meqë u konstatuar se dëmi ka ardhur me kontributin dhe fajin e pjesëmarrësve të përfshirë sipas grupit të ekspertëve, sipas Kolegjit vlejné dispozitat e përgjegjësisë sipas fajit nga Neni 154 par. 1 dhe Neni 158 të LMD-së.
30. Sipas Kolegjit fakti se gjykata e shkallës së parë në procedurat e zhvilluara ka nxjerrë provën me grup të ekspertëve, ekspertiza individuale e ekspertit Sami Isufi nuk mund të ketë peshë vendimtare në përcaktimin e fakteve që synon t’i provojë, ngase tanimë gjykata është e lidhur me ekspertizën e kryer nga institucioni përkatës. Së këndejmi, edhe Kolegji vlerëson se ekspertiza e grupit të ekspertëve ka qenë profesionale e bazuar në prova dhe dokumentacion të mjaftueshëm dhe se në procedurë nuk është kërkuar mjet tjetër provues. Aq më tepër të dyja palët ndërgjyqëse argumentet e tyre i mbështesin në konstatimet e grupit të ekspertëve – për aq sa i vlerësojnë në favor. Por nuk ka pasur kundërshtime në raport me të gjeturat e grupit të ekspertëve.

31. Nisur nga fakti se Kolegji gjeti se në rastin konkret nuk kemi përgjegjësi objektive, respektivisht palët me fajin e tyre kanë kontribuar në shkaktimin e dëmit, Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se ekspertët me të drejtë konstatojnë ndikimet e palëve në shkaktimin e dëmit.
32. Për Dhomën e shkallës së Dytë nuk është relevant aspekti i ndërtimit pa apo me leje urbanistike dhe ndërtimore të objekti dhe as aspekti i mosekzistimit të kontratës së shërbimit të ujit dhe kanalizimit mes këtu palëve ndërgjyqëse. Këto janë aspekte terciare në raport me gjykimin e çështjes ngase e para ka të bëjë me aspekte urbanistike jashtë domenit të përgjegjësisë për dëmin. Ndërsa mosekzistimi i kontratës së paditëses me të paditurën për shërbimet komunale të ujit, është i pa ndikim me faktin se përkundër mënyrës se si ishte kyçur paditësja, vet e paditura ka filluar ta tarifojë me fatura këtu paditësen që nga muaji mars 2009 – për çka ka prezantuar faturat. Pra edhe me dispozitat e LMD-së sa i përket kontratës (Shih Nenin 67 të LMD) kontrata nuk i nënshtrohet ndonjë forme. Me këtë rast me hyrjen në raport kontraktual dhe fillimin e tarifimit për shërbimet, e paditura nuk mund të thirret më në mungesën e kontratës si kusht për të mënjeluar raportin deliktor. Sepse paditësja pavarësisht mënyrës si ka filluar të ketë raport për shfrytëzimin e shërbimeve, me faktin se e paditura i ka lëshuar faturat për shërbime ka marr pjesën e përgjegjësisë ndaj konsumatorit. Rrjedhimisht për Kolegji përgjegjësia për dëmin vlerësohet vetëm në raport të veprimeve apo lëshimeve të palëve që kanë ndikuar drejtpërdrejtë në shkaktimin e dëmit, siç konstatojnë ekspertët në ekspertizën e grupit të ekspertëve.
33. Sipas Kolegjit ekspertët me të drejtë kanë përcaktuar përgjegjësitë e palëve të përfshira, e që gjykuar sipas përgjegjësisë nga faji, vërteton se pjesë të konsiderueshme të përgjegjësisë mban e paditura KUR “Prishtina” për shkak të mosmirëmbajtjes së rregullt të kolektorit të kanalizimit (pastrimi i rrjetit të kanalizimit dhe riparimi i pusetave) për lokacionin në fjalë ku ka ndodhur dëmi material. Po ashtu ekspertët me të drejtë përcaktojnë se e paditura nuk ka vepruar sipas akteve ligjore duke lëshuar të trajtojë lidhjen e paautorizuar. Sipas Kolegjit do të ndryshonte krejtësisht situata sikur e paditura të mos e faturonte paditësin. Mirëpo, fakti se e paditura ka filluar ta faturojë për shërbimet këtu paditësin, nënkupton se mes palëve ishte themeluar raporti kontraktual i shërbimit.
34. Për Kolegjin pjesën tjetër të përgjegjësisë e mbajnë bashkërisht paditësi si qiramarrës për shkak të lëshimeve që të sigurohet për kushtet adekuate të lokalit ku ka vendosur produktet medicinale dhe pronari i lokalit si qiradhënës i cili, siç u argumentua më sipër është gjykuar penalisht pikërisht për pjesën e tij të përgjegjësisë të cilën e konstatojnë ekspertët, respektivisht për veprim në kundërshtim me legjislacionin në fuqi - ka dëmtuar instalimet e kanalizimit qendror, në atë mënyrë që ilegalisht, pa leje nga organi kompetent e ka lidhur kanalizimin e objektit – podrumit në sistemin e kanalizimit të kompanisë së Ujësjetës Rajonal “Prishtina”.
35. Nga të lartcekurat, Dhoma e Shkallës së Dytë gjen se veprimi dëmtues rrjedh nga lëshimet e të paditurës e cila përgjigjet për dëmin sipas fajit të shkaktuar nga veprimi i saj konform dispozitave të nenit 154 par.1 dhe 184 të LMD-së. Ndërkaq në pasojat e dëmit, respektivisht shkaktimin e tij ka kontribuar edhe paditësi, respektivisht pronari i objektit të cilët secili për pjesën e vet të përgjegjësisë ndaj objektit të dhënë, respektivisht të marrë me qira, i cili ka pasur të meta në lidhjen në rrjetin e kanalizimit, kanë qenë kontribuues në veprimin që ka ardhur deri te dëmi.

36. Këto veprime, respektivisht lëshime të palëve të përfshira dhe pasoja e shkaktuar me depërtimin e ujërave të zeza në depon e paditësit janë në lidhje kauzale që kanë sjellë deri te dëmi material. Andaj, Kolegji vlerëson se në rrethanat e rastit konkret ekziston përgjegjësia e ndarë në raport 50% të kontributit nga e paditura për shkak të lëshimeve të saj në mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe pjesën prej 50 % të kontributit e bartin paditësi si qiramarrës, respektivisht qiradhënësi – pronari i lokalit.
37. Kjo Gjykatë gjykon se bazuar në kontributin në shkaktimin e dëmit, në rastin konkret gjen zbatim dispozita Neni 192 par.1 të LMD-së e cila përcakton se *“I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose te jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht, ka të drejtë vetëm për kompensim përpjestimisht të pakësuar”*.
38. Te përgjegjësia e ndarë shkaktari apo kontribuuesi në shkaktimin e dëmit merr përsipër dëmin në masë dhe vëllimin me të cilin ka kontribuar në shkaktimin e tij. Në situatën e gjykuar si në rastin konkret me përgjegjësinë e ndarë në mes të subjekteve (shih pika 36 më sipër) Gjykata ka për obligim të përcaktojë se cila pjesë e dëmit është shkaktuar me veprimin dëmtues të palëve që kanë shkaktuar dëmin apo kanë kontribuar në rritjen e tij. Mirëpo, Neni 192 par.2 i LMD-së ka përcaktuar se *“Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i dëmtuesit, gjykata do të gjykojë kompensimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit”*.
39. Nga të gjeturat e Kolegjit të Dhomave të Shkallës së Dytë për ndarjen e përgjegjësisë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret shuma e gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë duhet të përpjesëtohet sipas kontributit në shkaktimin e dëmit, duke gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
40. Ndonëse pala e paditur nuk ka pasur pretendime ankimore lidhur me lartësinë e dëmit të përcaktuar nga ekspertët financiarë, por vetëm sa i përket bazës juridike, Kolegji vlerësoi se lartësia e dëmit është trajtuar mjaftueshëm në gjykimin në shkallë të parë dhe palëve iu ka dhënë mundësia për nxjerrjen e mjeteve provuese. Në këtë drejtim Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk ia ka falë besimin ekspertizës financiare të punuar nga ekspertit z. Fetah Tahiri, pasi që e njëjta nuk ishte në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ndërkaq lartësia e dëmit material është përcaktuar bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit financiar Shaqir Merovci, të cilës gjykata e shkallës së parë ia kishte falë besimin. Kjo për faktin se ekspertiza ishte bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe për më tepër palët ndërgjyqëse gjatë procedurës të rigjykimit, nuk kanë pasur propozime të reja e as nuk kanë kërkuar sqarime apo vërejtje në ekspertizë.
41. Së këndejmi, kolegji shumë e gjykuar si në dispozitiv të përpjesëtuar sipas përgjegjësisë e bazoi në konstatimet e ekspertizës financiare të ekspertit Shaqir Merovci me të cilën ishte përcaktuar lartësia e dëmit.
42. Nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë në seancën e Kolegjit bazuar në provat

që gjenden në shkresat e lëndës vlerësoi ndryshe faktet vendimtare të çështjes dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar nga Kolegji e ndryshoi edhe të drejtën materiale të zbatuar nga gjykata e shkallës së parë, konform nenit 201 par. b) dhe 194 të LMD-së., andaj është dashur që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet pjesërisht si në dispozitiv.

43. Sa i përket shpenzimeve të procedurës duke u nisur nga gjykimi i çështjes, ku pala paditëse ka pasur sukses vetëm pjesërisht, Kolegji vendosi që konform Nenit 452 par.2 të LPK-së shpenzimet të përgjysmohen në raport me të gjykuarit në aktgjykimin e atakuar.
44. Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë gjeti se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje të konfliktit administrativ, prandaj në mbështetje të nenit 195, para. 1, pika (d), dhe nenit 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1411/24 datë 20.05.2025

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova

